



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit.	FSSH
Nr. i faqeve Br.stranica No. pages	1-
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	787
Data Datum Date	05.04.24
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravlja – Ministry of Health
Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health Insurance Fund
Bordi Drejtues – Upravni Odbor – Steering Board

Nr.05/10
Prishtinë, datë: 3 prill 2024

Në mbështetje të Nenit 28, të Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-042, si dhe neni 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 i Statutit të Fondit për Sigurim Shëndetësor. Bordi Drejtues i Fondit për Sigurim Shëndetësor, në mbledhjen e mbajtur me datë 03 prill 2024 merr:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Punës së Fondit për Sigurim Shëndetësor për vitin 2024.
2. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Arben Vitia
Kryesues i Bordit Drejtues të FSSH-së

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues të FSSH-së;
- Sekretarisë së Bordit Drejtues të FSSH-së dhe
- Arkivit të FSSH-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

PLANI I PUNËS 2024

FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Prishtinë
Prill 2024



TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
1.Mandati i Fondit për Sigurime Shëndetësore	4
2.Vizioni, misioni dhe vlerat themelore të Fondit	5
3.Struktura Organizative e Fondit	8
4.Buxheti i ndarë për Fondin për vitin 2024	10
5.Objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara për vitin 2024.....	11
Shtojca: Detajet mbi aktivitetet dhe nën-aktivitetet për realizimin e objektivave.....	13

1. Hyrje

Plani i punës për vitin 2024 për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (me tutje: Fondi) paraqet mënyrë të strukturuar të objektivave dhe aktiviteteve të identifikuara për krijimin e parakushteve themelore për funksionalizimin e Fondit i përcaktuar me Ligjin 04L/249 për Sigurimin Shëndetësor.

Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh burimet ekzistuese njerëzore dhe financiare me të cilat disponon Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Realizimi i këtij plani do të kontribuojë në realizimin e funksionit të Fondit, “Sigurimi i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor”. Ky plan përben instrument planifikimi dhe menaxhimi që siguron një kornizë për planifikimin e aktiviteteve, bartësve të tyre në raport me afatet kohore orientues, si dhe matësit e realizimit të këtyre aktiviteteve. Gjithashtu, ky plan përben një instrument të një rëndësie të veçantë dhe në të njëjtën kohë do të shërbejë si udhërrëfyes përgjatë vitit 2024 për të gjitha palët e interesit të përfshira në procesin e funksionalizimit të Fondit.

Brenda këtij plani janë paraqitur aktivitetet që duhet realizuar dhe veprimet që duhet ndërmarë gjatë vitit 2024 dhe jo domosdo për të gjitha aktivitetet e evidentuara bartëse e tyre është Fondi. Ky plan përpos aktiviteteve dhe veprimeve që hisedarët e ndryshëm duhet ndërmarë, njëkohësisht paraqet edhe kohën dhe angazhimin që personeli dhe menaxhmenti i Fondit do ta materializojnë në funksion të realizimit të tij.

2. Mandati i Fondit për Sigurim Shëndetësor

Ligji nr. 04/L-249 për Sigurim Shëndetësor, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 Prill 2014, ka siguruar bazën ligjore për sigurimin shëndetësor publik në vend.

Fondi është institucion publik me interes të posaçëm, me autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta, për zbatim të këtij ligji. Fondi autorizohet për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të të siguruarve, lidhur me sigurimin shëndetësor të obligueshëm, si dhe përcaktimin e listës së shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor.

Të punësuarit në Fond nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës dhe statusi i tyre rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Bordi Drejtues dhe të miratuar nga Qeveria. Fondi i nënshtrohet legjislacionit dhe rregullave të menaxhimit financiar në sektorin publik. Organizimi i shërbimit administrativ të Fondit përcaktohet me aktet e tij normative.

Fondi drejtohet nga Bordi Drejtues si organ më i lartë vendim-marrës i Fondit, ndërsa Drejtori i Fondit përgatit raporte periodike për Bordin Drejtues, siguron zbatimin efikas dhe efektiv të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, menaxhon aktivitetet operative të Fondit në baza ditore, si dhe përgatitë informata të rregullta individuale vjetore për të siguruarit përkitazi me Listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor, rezultatet menaxheriale si dhe informatat e tjera me rëndësi.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Fondit janë:

- zbaton politikat për përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe mbrojtjes nga rreziku financiar i popullatës, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;
- siguron zbatimin e të drejtave të siguruarve në pajtim me ligjin;
- organizon administratë profesionale që siguron zbatimin efikas dhe efektiv të të drejtave dhe obligimeve nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm;
- propozon për miratim në Qeveri, kontributet, bashkë-pagesat, bashkë-sigurimin, pagesat shtesë, dhe mjetet e tjera financiare për sigurimin shëndetësor të obligueshëm;
- siguron grumbullimin efikas dhe transparent të mjeteve financiare për sigurimin shëndetësor të obligueshëm, në pajtim me këtë ligj;
- përcakton kushtet e kontratës me institucionet shëndetësore për shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor përfshirë standardet e cilësisë që duhet të përmbushen;

- negocion dhe kontrakton shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor, përfshirë kushtet për ofrimin dhe kompensimin e shërbimeve cilësore shëndetësore që qojnë në produktivitet të shtuar dhe performancë më të lartë;
- zbaton kompensimin efektiv dhe me kohë të shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor të ofruara nga institucionet e kujdesit shëndetësor, bazuar në kontrata;
- shqyrton dhe propozon për Bordin Drejtues, çmimoren e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor;
- mbikëqyr zbatimin e të gjitha kontratave të lidhura nga Fondi dhe raporton përkitazi me to. Bordit Drejtues i raporton Drejtori i Fondit në lidhje me zbatimin e të gjitha kontratave për shërbime shëndetësor;
- organizon dhe zbaton sistemin e informimit për sigurime të obligueshme shëndetësore në kuadër të sistemit unik të informimit shëndetësor;
- kërkon dhe shfrytëzon vlerësimin profesional të punës së institucioneve shëndetësore nga institucionet e autorizuar;
- rregullon çështjet e tjera përkitazi me sigurimin shëndetësor në pajtim me aktet ligjore në fuqi; dhe
- kërkon auditim të jashtëm financiar të institucioneve shëndetësore që janë në marrëdhënie kontraktuale me Fondin.

3. Vizioni, misioni dhe vlerat themelore të Fondit

Vizioni

Vizioni i Fondit është të krijojë ndjenjë të sigurisë tek popullata, nga shpenzimet e mëdha në lidhje me problemet e tyre të mundshme shëndetësore dhe ndonjë trajtimi që mund t'ju nevojitet.

Misioni

Misioni i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është të jetë një institucion i besueshëm dhe në zhvillim të përhershëm, i aftë që të përmbushë funksionet e veta me përgjegjësi, integritet, përkushtim, profesionalizëm dhe transparencë, përmes aplikimit të praktikave më të mira, aplikimit të inovacionit teknologjik, efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe qëndrueshmërisë

financiare si një garanci për mbrojtje shëndetësore me kosto të përballueshme për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë pa përjashtim.

Vlerat themelore të Fondit

- **Synimet-** synojmë që të kemi zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në punonjës kompetentë dhe të orientuar drejtë rezultateve;
- **Transparenca dhe llogaridhënia-** të jemi të besueshëm, të hapur dhe të afërt. Vendimmarrja të jetë transparente dhe e vëmendshme ndaj të tjerëve; dhe
- **Bashkëpunimi-** të krijojmë një atmosferë besimi brenda institucionit tonë dhe në marrëdhëniet me partnerët dhe klientët.

4. Qëllimi i planit për vitin 2024


Të realizohen përgatitjet e nevojshme për zbatimin e skemës së sigurimit shëndetësor përmes avancimit të qeverisjes së mirë, fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Fondi do të synoj që gjatë vitit 2024 të realizoj një mori aktivitete në varësi nga kapacitetet njerëzore dhe mundësitë buxhetore. Synohet që të ruhet qëndrueshmëria institucionale dhe të pretendohet zhvillimi i disa dokumenteve draft-rregulloreve që do të mundësoj që vitin e ardhshëm të fillohet me finalizimin e tyre, përmes procesit të themelimit të komisioneve/grupeve punuese me gjithë përfshirje të institucioneve në rast se Ligji për Sigurim Shëndetësor aprovohet në Qershor 2024 ashtu siç është paraparë në Planin Legjislativ për vitin 2024.

5. Struktura Organizative e Fondit

Struktura Organizative e Fondit për Sigurime Shëndetësore përbëhet nga Zyra e Drejtorit të Fondit, katër (4) Departamenteve, si dhe katër divizione tjera të cilat i raportojnë direkt Drejtorit të Fondit.

Fig. 1: Struktura organizative e Fondit



6. Sfidat e Planit të Punës për vitin 2024

Numri i të punësuarve në Fond në fund të vitit 2023 ishte 41. Me Ligjin e Buxhetit për vitin 2024, nuk është planifikuar të fuqizohen kapacitetet njerëzore në Fond. Ky numër është tejet i pamjaftueshëm dhe se me këto kapacitete është e pamundur të funksionalizohet Fondi për të përmbushur misionin sipas Ligjit për Sigurim Shëndetësor.

Risk potencial për zbatim të këtij plani për vitin 2024 mund të jete mos miratimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili sipas Planit Legjislativ planifikohet të përmbyllet në Qershor të vitit 2024.

Sigurisht që implementimi i Skemës së Sigurimit Shëndetësor edhe pse mandat i Fondit, parapërgatitjet e nevojshme për zbatim të saj i takojnë shumë hisedarëve dhe se pa koordinimin dhe bashkëpunimin e tyre është vështirë e arritshme. Prej të gjithë hisedarëve, roli themelor i takon Ministrisë së Shëndetësisë.

Për të realizuar planin e punës për vitin 2024 është e domosdoshme:

- Mbështetja nga Qeveria në kompletimin e legjislacionit primar dhe sekondar;
- Aprovimin e buxhetit të nevojshëm për mbulimin e kostove operative dhe kapitale; dhe
- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore.

Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ Avancimi i Sistemit Informativ të Fondit; ▪ Integrimi i Regjistrave Qendror nga: MPMS, MSh, ATK, ARC, BQK, APPM, OFK me SIF-in;	▪ Korniza ligjore e pakompletuar; ▪ Numri i pamjaftueshëm i personelit; ▪ Mungesa e përvojës në administrimin e skemave komplekse të sigurimit shëndetësor; ▪ Mungesa e trajnimeve specifike të cilat lidhen me detyrat specifike të Fondit; ▪ Mungesa e përvojës në konceptimin dhe administrimin e fushatave të strukturuar për informimin dhe ndërgjegjësim.
Mundësitë	Rreziqet
▪ Vullneti politik i shprehur për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore; ▪ Interesimi i palëve të interesit për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore;	▪ Koordinimi i pamjaftueshëm brenda dhe ndërinstitucional; ▪ Jo stabiliteti politik eventual; ▪ Alokimet e pamjaftueshme buxhetore;

▪ Rritja e presionit publik për nevojën e funksionalizimit të Fondit; ▪ Gatishmëria e donatorëve dhe partnereve ndërkombëtar;	
--	--

7. Buxheti i Fondit për vitin 2024

Fondi si organizatë e veçantë buxhetore, në fazën tranzitore deri në fillimin e mbledhjes së kontributeve financohet nga buxheti i shtetit dhe i nënshtrohet rregullave të menaxhimit të financave publike. Në vitin 2024 Fondi i janë ndarë 8.87 milion€ buxhet, prej të cilave 8.0 milion€ janë në kategorinë e subvencioneve. Në këtë kategori kemi rritje të buxhetore krahasuar me vitet paraprake. Kjo kategori historikisht ka qenë i nën buxhetuar, përjashtimisht dy vitet e fundit ku kemi pasur rritje të buxhetit fillestar (2022-6 milion€, 2023-7 milion€ dhe 2024- 8 milion€). Po ashtu ndarjet e buxhetit shtesë në vitin 2023 prej 15 milion€ dhe rritje e buxhetit për vitin 2024 në 8.0 milion€ kanë ndikuar pozitivisht në uljen e detyrimeve dhe subvencionimin e shërbimeve në Programin e TMJISHP. Në kategorinë e pagave nuk kemi rritje të numrit të të punësuarve dhe po ashtu nuk kemi ndarje buxhetore për projekte kapitale. Në vijim buxheti i FSSH sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2024.

Kategoria	Buxheti sipas Ligjit 07/L-001	%
Paga dhe Mëditje	375,854.00	4.2
Mallra dhe Shërbime	476,817.00	5.3
Shpenzime komunale	25,000.00	0.3
Subvencione dhe Transfere	8,000,000.00	90.1
Total	8,877,671.00	100.0

8. Objektivat, rezultatet dhe aktivitetet e përcaktuara për vitin 2024

Në planin vjetor të punës për vitin 2024 janë prezantuar objektivat të cilët janë themel për krijimin e parakushteve të nevojshme për funksionalizimin e Fondit. Objektivat me tutje janë të zbërthyera në aktivitete dhe nën aktivitete, duke përfshirë kohën dhe njësitë/personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Në vijim janë prezantuar objektivat e përcaktuara si dhe rezultatet e pritura prej tyre.

Nr.	Objektivat	Rezultatet e pritura
1.	Menaxhimi efikas i Fondit dhe rritja e transparencës gjatë vitit 2024	- Raporti Vjetor i FSSH për vitin 2023, i hartuar; - Plani vjetor i punës së FSSH për 2024, I hartuar dhe aprovuar; - Regjistri i rreziqeve dhe monitorimi i tyre, i hartuar; - Buxheti i FSSH, i menaxhuar; - Plani për zbatimin dhe monitorimin i rekomandimeve nga NJAB dhe ZKA, monitoruar; - Programit për TMJIShP i administruar dhe menaxhuar;
2.	Menaxhimi i burimeve njerëzore të FSSH	- Plani i trajnimeve për stafin e Fondit i hartuar; - Plani i trajnimeve për stafin e Fondit i zbatuar; - Stafi sipas Rregullores për sistematizimin dhe klasifikim të vendeve të punës në Fondit, i rekrutuar; - Rregulloret e brendshme të harmonizuara me Ligjin për zyrtaret publik; - Pagat e stafit të Fondit, të administruara; - Vijueshmëria a stafit të Fondit, e mbikëqyrur;
3.	Zhvillimi i komunikimit me media, publikun dhe rritja e transparencës	- Komunikimit me media, publikun dhe rritja e transparencës, i avancuar; - Publikimet dhe mirëmbajtja e Web faqes së Fondit, të realizuara; - Procedura standarde për operative për komunikim, e hartuar;

4	Hartimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve sipas Planit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2024	▪ UA 03/2023 për TMJIShP, i plotësuar; ▪ Rregullorja e Brendshme për sistematizim dhe klasifikim të vendeve të Punës në Fond, e plotësuar;
5	Hartimi i Drafteve fillestare të Rregulloreve të nevojshme për kontraktim të institucioneve shëndetësore bazuar në praktikën e vendeve të rajonit	▪ Drafti fillestar i rregullores: “Kushtet e përgjithshme të kontratës për Kujdesin Parësor Shëndetësor”, i hartuar; ▪ Drafti fillestar i rregullores: “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Shërbimin Specialistik-Konsultativ”, i hartuar; ▪ Drafti fillestar i rregullores: “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Kujdesin Spitalor Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor”, hartuar; ▪ Drafti fillestar i rregullores: “Kriteret për lidhjen e kontratave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mënyrën e pagesës për shërbimet shëndetësore” i hartuar; ▪ Drafti fillestar i rregullores: “Metodologjia e hartimit të planit të punës së institucioneve shëndetësore për shërbimet të cilat kontraktohen nga Fondi (plani i numrit dhe llojit të shërbimeve shëndetësore)”, i hartuar; ▪ Drafti fillestar i rregullores: “Kontraktimi i barnatoreve për listën e barnave jashtë spitalore”, i hartuar; ▪ Drafti fillestar i “Kontratës për kontraktimin e barnatoreve jashtë spitalore” i hartuar; ▪ Bashkëpunimi i Fondet me Fondet e vendeve të rajonit dhe partneret ndërkombëtar, i avancuar

Shtojca: Detajet mbi rezultatet, aktivitetet dhe nën aktivitetet për realizimin e objektivave dhe qëllimit

Objektivi	Aktivitetet	Nënaktivitetet	Muaj												Mjetet e verifikimit	Përgjegjës
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12		
O1: Menaxhimi efikas i Fondit dhe rritja e transparencës gjatë vitit 2024																
1: Hartimi i Raportit Vjetor i FSSH për vitin 2023																
		Themelimi i ekipit për hartimin e raportit vjetor të punës të FSSH për 2023													Vendimi	Drejtori
		Puna ne hartimin e raportit vjetor të punës për vitin 2023													Draft Raporti	Grupi Punues
		Raporti vjetor final për vitin 2023													Drafti final	Drejtori/Bordi Drejtues
2: Hartimi i Planit vjetor të punës së FSSH për 2024																
		Themelimi i ekipit për hartimin e planit vjetor të punës të FSSH për 2024													Vendimi	Drejtori
		Puna e hartimin e planit vjetor të punës për vitin 2024													Lista e pjesëmarrësve; Procesverbalet	Kryesuesi
		Plani vjetor final për vitin 2024													Drafti final	Drejtori/Bordi Drejtues
3: Hartimi i regjistrimit të rreziqeve dhe monitorimi i tyre																
		Krijimi i grupit të punës për identifikimin e rreziqeve													Vendimi	Drejtori
		Puna e grupit punues në hartimin e regjistrimit të rreziqeve													Lista e pjesëmarrësve; Procesverbalet	Kryesuesi

	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e regjistrit të rreziqeve															Vendimi	Drejtori
	Hartimi i raporteve monitoruese të rreziqeve															Raportet e monitorimit	Zyrtari përgjegjës
5. Menaxhimi i buxhetit të FSSH																	
	Hartimi i planit të rrjedhjës së parash dhe raportimi periodik i shpenzimeve sipas planit të rrjedhjës së parash															Plani i rrjedhjës së parash	Dep. për Financa
	Raportimi i obligimeve nga viti paraparak si dhe raportimi periodik i obligimeve dhe detyrimeve kontingjente															Lista e obligimeve dhe raportimi mbi pagesën	Dep. për Financa
	Regjistrimi i rregullt i pasurisë (pranuar/blerë)															Regjistrimi në sistem	Zyrtari i pasurisë
	Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë															Raporti i inventarizimit dhe raporti i vlerësimit të pasurisë	Kryesueset e Komisioneve
	Hartimi i pasqyrave financiare vjetore															Pasqyrat financiare vjetore të aprovuara	Dep. për Financa Drejtori
	Barazimet financiare me institucionet shëndetësore për TMJIShp															Raportet e barazimeve më ISHP	Komisioni i barazimeve
5. Zbatimi dhe monitorimi i rekomandimeve nga NJAB dhe ZKA																	
	Hartimi i planit të veprimt për zbatimin e rekomandimeve të ZAP dhe NJAB															Plani i veprimt	Zyrtari i caktuar me vendim

	Monitorimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve																		Raport mbi progresin e implementimit të rekomandimit	Zyrtari i caktuar me vendim	
6: Menaxhimi i Programit për TMJIShP																					
	Procesi administrativ i pranimit të aplikacioneve, informimit dhe procedimit tek trupat vendimmarrëse si dhe iniciimi i pagesave në DFShP Kommunikimi dhe ofrimi i informacioneve për palët e interesuara Raportimi në DFShP i obligimeve si dhe detyrimeve kontingjente Përgatitja e kërkesave (specifikave) teknike për sistemin për menaxhimin e programit për TMJIShP																			Divizioni për TMJIShP	
																					Divizioni për TMJIShP
																					Divizioni për TMJIShP
O2: Menaxhimi i burimeve njerëzore të FSSh																					
1. Hartimi i planit të trajnimeve për stafin e Fondit																					
	Themelimi i Grupit punues																		Vendimi	Drejtori	
																			Procesverbalet; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi	
	Drafti final i planit të trajnimeve																		Drafti final i Planit		
2. Zbatimi i planit të trajnimeve për stafin e Fondit																			Divizioni i Burimeve Njerëzore		

3. Rekrutimi i stafit sipas Rregullores për sistematizimin dhe klasifikim të vendeve të punës në Fondit															Divizioni i Burimeve Njerëzore
Shpallja e konkurseve															Divizioni i Burimeve Njerëzore
Krijimi i komisioneve															Drejtori
Përzgjedhja e candidateve															Komisioni
4. Harmonizimi i Rregulloreve të brendshme në përputhje me Ligjin për zyrtaret publik															
Themelimi i Grupit punues															Vendimi
Puna e grupit punues															Procesverbalet; Lista e pjesëmarrjes
Drafti final															Drafti final i rregullores
5. Administrimi i pagave të stafit të Fondit															Divizioni i Burimeve Njerëzore
6. Mbikëqyrja e vijueshmërisë të stafit të Fondit															Divizioni i Burimeve Njerëzore
O3: Zhvillimi i komunikimit me media, publikun dhe rritja e transparencës															
1. Publikimet dhe mirëmbajtja e Web faqes së Fondit															Divizioni
2. Komunikimi me mediat dhe palët e interesit															Divizioni
3. Hartimi i procedurës për komunikim															

	Themelimi i grupit																	Vendimi	Drejtori
	Puna e grupit punues																	Procesverbalet e takimeve	Kryesuesi
	Drafti final																	Kryesuesi	Kryesuesi
O4: Hartimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve sipas Planit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2024																			
1. Plotësim/ndryshimi i UA 03/2023 për TMJIShP																			
	Themelimi i Grupit punues																	Vendimi	Ministri
	Puna e grupit punues																	Procesverbalet; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Draftimi final i UA																	Drafti final i UA	Kryesuesi
2. Plotësim/ndryshimi i Rregullores së Brendshme për sistematizim dhe klasifikim të vendeve të Punës në Fond																			
	Themelimi i grupit punues për hartimin e propozim rregullores së FSSh																	Vendimi	Bordi Drejtues
	Puna e ekipit në hartimin e propozim rregullores së brendshme për FSSh																	Procesverbalet; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i Propozim rregullores së brendshme për FSSh																	Drafti final i rregullores	Kryesuesi
O5: Hartimi i Drafteve fillestare të Rregulloreve të nevojshme për kontraktim të institucioneve shëndetësore bazuar në praktikat e vendeve të regjionit																			
1. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores: “Kushtet e përgjithshme të kontratës për Kujdesin Parësor Shëndetësor”																			

	Themelimi i grupit punues																	Vendimi	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																	Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i Draft- Rregullores																	Drafti Final	Kryesuesi
2. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores:																			
“Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Shërbimin Specialistik-Konsultativ”																			
	Themelimi i grupit punues																	Vendim	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																	Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i draftit të rregullores																	Drafti final	Kryesuesi
3. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores:																			
“Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Kujdesin Spitalor Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor”																			
	Themelimi i grupit punues																	Vendimi	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																	Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i draftit të rregullores																	Drafti final	Kryesuesi
4. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores:																			
“Kriteret për lidhjen e kontratave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mënyrën e pagesës për shërbimet shëndetësore																			
	Themelimi i grupit punues																	Vendimi	

	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																		Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i draftit të rregullores																		Drafti final	Kryesuesi
5. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores: “Metodologjia e hartimit të planit të punës së institucioneve shëndetësore për shërbimet të cilat kontrahohen nga Fondi (plani i numrit dhe llojit të shërbimeve shëndetësore)”																				
	Themelimi i grupit punues																		Vendimi	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																		Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i draftit të rregullores																		Drafti final	Kryesuesi
6. Hartimi i Draftit fillestar të Rregullores: “Kontraktimi i barnatoreve për listën e barnave jashtë spitalore”																				
	Themelimi i grupit punues																		Vendimi	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																		Procesverbalet e takimeve; Lista e pjesëmarrjes	Kryesuesi
	Finalizimi i draftit të rregullores																		Drafti final	Kryesuesi
7. Hartimi i Draft-kontratës për kontraktimin e barnatoreve jashtë spitalore																				
	Themelimi i grupit punues																		Vendimi	
	Puna e grupit punues për draftimin e rregullores																		Procesverbalet e takimeve;	Kryesuesi

[illegible]